



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Prodator Received/Delivery	27 - 10 2022	2 viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Ri Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	6545/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. nr.750/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga; Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi, dhe Jeton Koca, anëtar, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A. Nr. 750/2022, të datës 31.08.2022, së ankueses nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dh , në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.750/2022 e datës 31.08.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. **OBLIGOHET** Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që të bëjë plotësim ndryshimin në listën e pagave për ankuesen dhe e njëjta të paguhet sipas koeficientit (9.5).
- III. **OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në *pikën II të dispozitiv*, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja më datë 31.08.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për zbatimin e plotë të vendimit Nr. 07/2012 i datës 09.07.2020 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës si dhe Vendimit me numër protokoli 32.08.2020 i datës 29.06.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 05.09.2022, ka bënë kërkesë për përgjigjen në ankesë tek Ministria e Industrisë Ndërmarrësi dhe Tregtisë, ndërsa më datë 08.09.2022, Ministria e Industrisë Ndërmarrësi dhe Tregtisë, ka dërguar përgjigje në ankesë tek Këshillit.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë 13.10.2022 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë vendimin me shifër VK.nr.118-1/2022, përmes të cilit ankesës së ankueses A.nr.750/2022 të datës 31.08.2022 i vazhdohet afati i vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë, ditë të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.750/2022 e datës 31.08.2022 e parashtruar nga ankuesja me numër protokoli 5043/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 03.08.202, me numër protokoli 1053; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 01.04.2010; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërim i datës 24.07.2013; Vendimi i datës 09.07.2022, me numër protokoli 07/12, Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Vendimi i datës 29.06.2020, me numër protokoli 3208; Akt emërimin i datës 31.01.2012; Përshkrimi i detyrave të Punës; Lista e pagave; Përgjigje në ankesë e datës 08.09.2022, me numër 525/2022, Shkresën e datës 20.11.2014 të Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil; Formularin për plotësimin dhe ndryshimin e listës së pagave i datës 10.08.2022; E-mailin e datës 24.08.2022 dërguar nga A.T për A.D me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 (tre) faqesh.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga
është pjesërisht e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të administruara të lëndës, ka konstatuar se ankuesja sipas Ndryshimit dhe plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 24.07.2013 është emëruar në pozitën "Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa" më koeficient nëntë (9), ndërsa përmes Vendimit Nr.prot:3208 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë i datës 29.06.2020 ankuesja është caktuar Zyrtare Kryesore Financiare.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit në bazë listës së pagave për muajin shtator 2022 ka konstatuar faktin se ankuesja paguhet sipas koeficientit nëntë (9), ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burime Njerëzore me datë 10.08.2022 e ka përcjellë në Thesarin e Republikës së Kosovës, plotësimin e ndryshimit të formularit të pagës me kërkesën që e njëjta të paguhet me koeficient dhjetë (10) dhe si datë e ndryshimit të pagës të llogaritet data 01.08.2022, mirëpo



përmes e-mailit të datës 22.08.2022 Zëvendës Udhëheqësi i Divizionit të Pagave në Thesarin e Kosovës i ka kthyer përgjigje negative, citoj: *"kërkesa juaj e bashkangjitur në attachment nuk i plotëson kriteret për procesin sepse në vendim nuk e keni cekur se personi në fjalë është ushtrues detyre apo zëvendësues dhe periudhën kohore"*, po ashtu edhe përmes e-mailit të dytë i njëjti me datë 24.08.2022 i kthen përgjigje sërish Njesisë për Menaxhimin e Burime Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, citojë: *"... e Divizionit për Buxhet dhe Financa, me vendim nuk mund të caktohet Zyrtare Kryesore Financiare, pra të ketë avancim pa procedura (rekrutim) me vendim mund të caktohet vetëm si ushtruese e detyrës apo zëvendësuese me afat të caktuar.*

Ankuesja e pakënaqur me përgjigjen e dhënë nga ana e Thesarit të Republikës së Kosovës, përmes procesin e pagesës sipas koeficientit dhjetë (10), ka parashtruar ankesë në Këshill me pretendimet ankimore që sipas dispozitave ligjore në fuqi të Ligjit Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Këshilli të aprovojë ankesën e ankueses sikurse edhe të obligojë Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si dhe Thesarin e Republikës së Kosovës që të bëjë zbatimin e Vendimit me numër Nr.prot:3208 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë i datës 29.06.2020 ankuesja është caktuar Zyrtare Kryesore Financiare.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar përmbajtjen e Vendimit me numër Nr.prot:3208 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë i datës 29.06.2020, dhe ka konstatuar se sipas këtij vendimi ankueses nuk i është ndryshuar koeficienti, madje çështja e pagesës ndryshe nga akti i emërimit të datës 24.07.2013 nuk është trajtuar me këtë vendim, mirëpo duke iu referuar nenit 21 paragraf 2 të Ligjit Nr.06/1-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura përcaktohet se: *"Shërbimet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar (në vijim: shërbimi i menaxhimit financiar) kryhen të gjitha së bashku nga një njësi administrative, që i raporton drejtpërdrejt Sekretarit të Përgjithshëm. Udhëheqësi i kësaj njësie është njëkohësisht zyrtar kryesor financiar, i cili menaxhon financat publike në përputhje me ligjin"* si dhe në mbështetje edhe të nenit 7 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike ku përcaktohet se: *"Zyrtari kryesor financiar në nivelin kryesor të subjektit publik, është në vartësi të drejtpërdrejtë dhe llogaridhënës ndaj Zyrtarit kryesor administrativ për operacionet financiare, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të subjektit publik"*, andaj meqenëse ankuesja vazhdon të kryej detyrat dhe përgjegjësit e Zyrtarit Kryesor Financiar, dhe për këto detyra i raporton drejtpërdrejtë Zyrtarit Kryesor Administrativ i takon të kompensohet në vlerën e koeficientit nëntë pikë pesë (9.5) sipas shkresës së datës 20.11.2014 të Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil, lidhur me vendosjen e koeficientit sipas pozitës përkatëse, si në vijim: *"për pozitën drejtor të drejtorisë/Drejtoratit në agjenci dhe Udhëheqës të divizionit të cilët i përgjigjen drejtpërdrejtë zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në Ministri, të vendoset koeficienti 9.5"*.

Kolegji i Këshillit, pas analizimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në konstatimet e dhëna në arsyetimin e këtij vendimi, ankesën e ankuesit 31.08.2022 është aprovuar pjesërisht si e bazuar, respektivisht Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me rastin e zbatimit të këtij vendimi obligohet që të bëjë plotësim ndryshimin e listës së pagave për ankuesen dhe e njëjta të kompensohet me koeficient nëntë pikë pesë (9.5).

Andaj, duke bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit sipas nenit 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenit 18 paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës , Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A nr. 750/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ;
- Arkivit të KPMSHCK-së,